

Ref.No. 20/2021 date: 06/04/2021

KONTRATË
PËR AKTIVITETET PËR ZHVILLIMIN E KOMUNITETËVE NË KOMUNËN E VITISË

Kjo kontratë për aktivitetet për Zhvillimin e Komunitetëve, sipas kushtëve dhe afatëve të përcaktuara me këtë kontratë, (në tekstin e mëtejme referuar si "Kontrata"), është lidhur në Komunën e Vitisë, mars 2021, ndërmjet palëve kontraktuese si në vijim:

FOUNDATION KOSOVO-LUXEMBOURG, organizatë jo-qeveritare vendore, e regjistruar pranë Departamentit për Organizatat Joqeveritare në Ministrinë e Administratës Publike, me numër të regjistrimit të OJQ-së 5200306-7, me seli të zyrës në adresën rruga Ejup Rexhepi 9A, 70000 Ferizaj, Kosovë, përfaqësuar nga z. Fisnik Beqiri, Drejtor Menaxhues, me autorizimet e nevojshme,

Në tekstin e mëtejme referuar si "**Foundation Kosovo-Luxembourg**";

Dhe

KOMUNA E VITISË, e përfaqësuar nga z. Sokol Haliti, Kryetar i Komunës,

Në tekstin e mëtejme referuar si "Komuna e Vitisë";

Dhe

KOMUNITETI SMIRË, TË KOMUNËS SË VITISË, të përfaqësuar nga z. TAJAR HYSENI, Kreu i komunitetit Smirë.

Në tekstin e mëtejme "Komunitetet Smirë" ose "Përfituesi".

Palët së bashku në tekstin e mëtejme referohen si "**Palët**".

RECITALET

DUKE PASUR PARASYSH, se zhvillimi i përgjithshëm i komuniteteve të caktuara, fshatrave apo komunave në Kosovë, qëndron në identifikimin e duhur dhe parashtrimin e nevojave, prioritetëve dhe kërkesave të komunitetit dhe të popullatës lokale në komunë dhe qeverinë qendrore, organizatat donatore dhe bizneset, përmes qasjes nga poshtë-lartë në vend se të jetë një qasje ndryshe nga zgjidhjet e imponuara nga qeveritë lokale dhe qendrore përmes zgjidhjeve nga lartë-poshtë.

KU, Foundation Kosovo-Luxembourg, Komuna e Vitisë dhe Komuniteti në Smirë kanë përcaktuar dhe kanë vullnetin që të bashkëpunojnë në implementimin e aktiviteteve me qëllimin e përgjithshëm që të krijojnë zhvillim të qëndrueshëm të Komunitetit në Smirë.

ME QËLLIM TË përcaktimit të të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësive të përbashkëta të palëve të cilat burojnë nga kjo Kontratë e Përbashkët,

Palët janë pajtuar me sa vijon:

NENI 1

OBJEKTI DHE FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

1. Objekti i kësaj kontrate është implementimi i përbashkët i aktiviteteve nga palët nënshkruese të kësaj kontrate në aktivitete konkrete përmes qasjes për zhvillim të komunitetit në fushën e aktiviteteve të gjenerimit të të hyrave dhe arsimimit, me qëllim të zhvillimit të komunitetëve, zbatuar nga Foundation Kosovo-Luxembourg në bashkëpunim me Komunën e Vitisë dhe Komunitetin Smirë bazuar në definicionet dhe kushtet, afatet dhe obligimet e parapara me këtë kontratë.

2. Palët pajtohen si vijon :

- a. Foundation Kosovo- Luxembourg obligohet të participojë me më së shumti 90,000.00 (nëntë dhjetë mijë) Euro ose 100 % të shumës së përgjithshme të financimit;
- b. Komuna e Vitisë nuk obligohet të participojë;
- c. Komuniteti Smirë do të ofrojë punë vullnetare në rast nevojë;

3. Kohëzgjatja e kësaj kontrate dhe për zhvillimin e komunitetit në Komunën e Vitisë sipas kushteve të kësaj kontrate fillon në muajin mars 2021 dhe përfundon në fund të muajit dhjetor 2022.

NENI 2

DETYRIMET E FOUNDATION KOSOVO-LUXEMBOURG

1. Foundation Kosovo-Luxembourg do të kontribuojë dhe alokojë fonde për implementimin e aktiviteteve në bazë të kësaj kontrate, në shumën e përcaktuar me nenin 3 të kësaj kontrate.

2. Foundation Kosovo-Luxembourg do të implementoj aktivitetet bazuar në këtë kontratë dhe do të kryejë të gjitha aktivitetet bazuar në sistemin e tij ndërkombëtar të menaxhimit të kualitetit (International Quality Management System).

3. Foundation Kosovo-Luxembourg do të caktojë pjesëtarë të personelit të devotshëm, profesional dhe të përgjegjshëm me qëllim të zbatimit të duhur të aktiviteteve.

4. Foundation Kosovo-Luxembourg do të pranojë, shqyrtojë dhe përfundimisht do të vendos lidhur me aktivitetet e propozuara dhe të parashtruara nga Komuniteti Smirë të cilit do të financohen

sipas kësaj kontrate dhe do të asistojë dhe sigurojë implementimin e duhur nga përfituesi i aktiviteteve të aprovuara dhe propozuara.

5. Foundation Kosovo-Luxembourg do të implementoj dhe kryejë procedurat e prokurimit për punët ose shërbimet e kontraktuara të cilat duhet të sigurohen si pjesë e ciklit të menaxhimit të aktiviteteve, në pajtim me rregullat e tij të brendshme të prokurimit.

6. Foundation Kosovo-Luxembourg rregullisht do të organizojë dhe mbajë mbledhje me Komunën e Vitisë dhe Komunitetit Smirë për të diskutuar, ndër të tjera, progresin e aktiviteteve, aktivitetet e parashtruar dhe selektuar për implementim, si.

7. Foundation Kosovo-Luxembourg do të ndërmarrë aktivitete të monitorimit me mjetet dhe procedurat e përcaktuara nga Foundation Kosovo-Luxembourg, për të siguruar implementimin e duhur të aktiviteteve dhe qëndrueshmërinë e aktiviteteve.

NENI 3

DETYRIMET E KOMUNËS SË VITISË

1. Komuna e Vitisë do të caktojë personin kontaktues për komunën në implementimin e aktiviteteve dhe personit të caktuar do t'ia caktojë përgjegjësitë në kuadër të kontratës.

2. Komuna e Vitisë do të marrë pjesë dhe do të informohet në të gjitha ciklet e aktiviteteve, ndër të tjera edhe për aktivitetet e propozuara të përfituesve, progresin në implementimin e aktiviteteve, tenderimin dhe procedurat e prokurimit.

3. Komuna e Vitisë nuk do të ketë asnjë kompetencë tjetër vendimmarrëse përveç kompetencës vendimmarrëse të përcaktuar në kuadër të kësaj kontrate.

4. Komuna e Vitisë do të sigurojë tërë përkrahjen dhe asistencën e saj lidhur me lejet e komunës, pëlqimet, licencat dhe punët tjera administrative të cilat mund të kërkojnë gjatë ciklit të implementimit të aktiviteteve. Përveç kësaj, nga Komuna e Vitisë pritet që të luajë rol në koordinimin dhe lehtësimin e procedurave në raport me përfituesit në identifikimin e nevojave të tyre, prioritetëve dhe aktiviteteve që do të përkrahen dhe financohen si pjesë e kësaj kontrate.

5. Komuna e Vitisë do të marrë pjesë në monitorimin dhe vëzhgimin e aktiviteteve të implementimit.

6. Komuna e Vitisë do të sigurojë dhe kryejë punët dhe shërbimet e mirëmbajtjes së bashku me Komunitetin Smirë dhe do të sigurojë qëndrueshmërinë e aktiviteteve që do të implementohen si pjesë e aktiviteteve të përbashkëta.

NENI 4

DETYRIMET E KOMUNITETIT SMIRË

1. Komuniteti Smirë, do të identifikojnë nevojat, prioritetet, fushat dhe mjetet e intervenimit të komunitetit përmes një qasje gjithëpërfshirëse dhe procesit të konsultimeve me/dhe ndërmjet të gjithë pjesëtarëve të komunitetit, përfshirë këtu edhe respektimin e së drejtës për pjesëmarrje të grupeve të marginalizuara.
2. Përfituesit individual të cilët do të përzgjidhen që të përkrahen me pajisje apo mjete pune do të participojnë financiarisht në bazë të kushteve të specifikuara në kontratat individuale të posaqme mes FKL dhe përfituesit.
3. Komuniteti Smirë, do të participojnë në ciklin e implementimit të aktiviteteve përmes sigurimit të punës së tillë apo shërbimeve siç mund të kërkohet për nevoja të zbatimit të duhur të aktiviteteve, siç janë, ndër të tjera, puna fizike, planifikimi dhe kryerja e punëve, sigurimi i ekspertizës ose shërbimeve.
4. Komuniteti Smirë, do të sigurojë vend për zyre ose hapësirë për mbledhjet që do të mbahen ndërmjet palëve përderisa një gjë e tillë do të jetë e nevojshme në baza ad hoc.
5. Komuniteti Smirë, do të caktojë përfaqësuesin i cili do ta përfaqësojë komunitetin në procesin e mbikëqyrjes së implementimit të aktiviteteve.
6. Komuniteti Smirë, do të sigurojë kontributet e premtuara nga formularët e aplikimit përderisa kjo kërkohet për komponentat e aktiviteteve për implementimin e duhur të aktiviteteve.
7. Komuniteti Smirë, do të informojë popullatën lokale me të gjitha mjetet e aplikueshme jo më pak se katër (4) herë në vit për aktivitetet e implementuara si pjesë e kësaj kontrate nga Foundation Kosovo Luxembourg dhe do të sigurojnë pjesëmarrjen e popullatës lokale në identifikimin e nevojave, implementimin e aktiviteteve, pjesëmarrjen në trajnime dhe aktivitete tjera që do të implementohen si pjesë e kësaj kontrate.
8. Komuniteti Smirë, do të kenë të drejtë të monitorojnë implementimin e aktiviteteve dhe kërkimin e informatave nga Foundation Kosovo-Luxembourg ose nga Komuna e Vitisë.
9. Komuniteti Smirë, do të sigurojë pronësinë vendore të aktiviteteve, përfshirë identifikimin e nevojave dhe prioritetëve përmes qasjes gjithëpërfshirëse dhe gëzimit të të gjithë përfitimeve nga i tërë komuniteti pa asnjë diskriminim.
10. Komuniteti Smirë, së bashku me Komunën e Vitisë do të sigurojë qëndrueshmëri dhe mirëmbajtje të punëve dhe aktiviteteve të implementuara si pjesë e kësaj kontrate.
11. Komuniteti Smirë, do të sigurojë përfaqësimin e interesave më të mira të banorëve dhe të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve dhe jo interesat personale dhe private të individëve apo një numri të vogël njerëzish.

NENI 5
MOS-APLIKIMI I LEGJISLACIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS

1. Në rast të nevojës për prokurimin e produkteve dhe pajisjeve të ndryshme apo të shërbimeve për përfituesit e aktivitetit të shpallur nga ana e Foundation Kosovo-Luxembourg, përgjegjës për procedurat e prokurimit do të jetë ekskluzivisht Foundation Kosovo-Luxembourg.
2. Legjislacioni i aplikueshëm i Republikës së Kosovës në fushën e prokurimit dhe mekanizmat për ankesa administrative (Organi Shqyrtues i Prokurimit) të parapara me Ligjin Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik dhe Ligji Nr. 05/L-092 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L- 237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068 nuk do të aplikohen.
3. Prokurimi do të udhëhiqet sipas Rregullave të brendshme të Prokurimit të Foundation Kosovo-Luxembourg si implementuese e aktivitetit, dhe të gjitha kërkesave substanciale për të garantuar një proces të hapur, të drejtë, pa diskriminime dhe i cili siguron kushtet më të mira për donatorët sikurse parashihet me standardet ligjore të Ligjit Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.
4. Çdo proces i prokurimit do të dokumentohet sipas standardeve më të mira të prokurimit publik, dhe do të ruhet për një periudhë prej 2 viteve që nga data e përfundimit të një aktiviteti të tillë të prokurimit.

NENI 6
SISTEMI I PËRCAKTIMIT TË KOMISIONIT VLERËSUES DHE PROCEDURA E
VENDIMMARRJES

1. Foundation Kosovo-Luxembourg do të përcaktojë personat e autorizuar të cilët do të marrin pjesë në Komisionin Vlerësues të aplikacioneve. Në anën tjetër, Kryetari i Komunës së Vitisë, apo personat e autorizuar nga ai, do të përcaktojë personin e autorizuar i cili do të marrë pjesë në Komisionin Vlerësues të aplikacioneve. Në lidhje me këtë palët do të njoftojnë njëra tjetrën sipas kushteve të kësaj kontrate.
2. Komisionet do të organizohen dhe menaxhohen sipas procedurave dhe rregullave të brendshme të Foundation Kosovo-Luxembourg. Përfaqësuesi i Vitisë do të respektojë

kriteret e vlerësimit, dhe asnjë presion mbi zgjedhjen e përfituesve nuk do të merret parasysh.

3. Anëtarët e Komisionit duhet të deklarohen dhe të bëjnë një njoftim me shkrim në rast të konfliktit të interesit me ndonjë prej aplikuesve, dhe në mënyrë automatike të përjashtojnë veten nga rekomandimi apo votimi në raste të tilla. Foundation Kosovo-Luxembourg ka të drejtë të mos përkrahë aktivitetet për të cilat njoftohet se ka pasur konflikt interesi nga përfaqësuesit e Komisionit të vlerësimit.
4. Anëtarët e Komisionit vlerësues janë tërësisht të pavarur në procesin e vlerësimit dhe vendim-marrjes në rastin e vlerësimit të aplikacioneve. Në rast se Foundation Kosovo-Luxembourg vlerëson se ka pasur ushtrim të çfarëdo ndikimi rezervon të drejtën që të anulojë tërësisht aktivitetin e aprovuar për mbështetje.

NENI 7

SISTEMI I MONITORIMIT TË KONTRATAVE

1. Pas vendimit të Komisionit vlerësues për përzgjedhjen e përfituesve të aktivitetit, Kontrata do të nënshkruhet nga ana e përfaqësuesit të Foundation Kosovo-Luxembourg.
2. Kushtet e Kontratës për përfituesit e aktivitetit do të draftohen nga ana e Foundation Kosovo-Luxembourg dhe për të njëjtën përmbajtje paraprakisht do të konsultohet edhe Komuna e Vitisë.
3. Sistemi i monitorimit të zbatimit të Kontratës nga ana e përfituesit do të jetë përgjegjësi e Foundation Kosovo-Luxembourg, për të cilin sistem do të informohet edhe Komuna e Vitisë. Komuna e Vitisë gjithashtu ka të drejtë të ketë sistemin e vetë të monitorimit të zbatimit të Kontratës, por edhe të ketë qasje në të dhënat e monitorimit nga ana e Foundation Kosovo-Luxembourg.
4. Në rast të shkeljeve të rënda të Kontratës nga ana e përfituesit, Foundation Kosovo-Luxembourg ka të drejtë ekskluzive të ndërprerjes së Kontratës me përfituesin. Në raste të tilla, Foundation Kosovo-Luxembourg do të konsultohet me Komunën e Vitisë dhe do të bashkëpunoj me mirëbesim, megjithatë vendimi i fundit për ndërprerje të Kontratës i takon ekskluzivisht Foundation Kosovo-Luxembourg.
5. Në rastet kur Komuna e Vitisë është e pakënaqur me performancën e Kontratës nga ana e përfituesit, Komuna do të njoftojë Foundation Kosovo-Luxembourg me sygjerimet përkatëse për veprimet të cilat duhet të ndërmerren. Vendimi i fundit megjithatë i takon Foundation Kosovo-Luxembourg.

6. Vendimet për të ndjekur përfituesit e aktivitetit përmes mekanizmave ligjorë për kompensimin e dëmit për shkak të mos-përmbushjes së kontratës apo të keqpërdorimeve tjera, do jenë në përgjegjësi të Komunës së Vitisë.

NENI 8

KOHËZGJATJA DHE SHKËPUTJA E KONTRATËS

1. Kjo kontratë fillon më 01. Mars. 2021 dhe zgjatë deri më 31. Dhjetor. 2022.
2. Palët nuk kanë të drejtë që të shkëpusin në mënyrë të njëanshme këtë kontratë përderisa ndonjëra nga to të mos shkelë ndonjërin prej obligimeve që dalin nga kjo kontratë.
3. Palët mund të shkëpusin këtë kontratë me marrëveshje të dyanshme dhe në momentin që janë përmbushur të gjitha obligimet që dalin nga kjo kontratë.
4. Në rast se ndonjëra nga palët shkelë obligimet e veta të parapara me këtë kontratë, pala e dëmtuara do të ketë të drejtën e kërimit të kompensimit të dëmeve nga pala shkelëse e obligimeve që dalin nga kjo kontratë.

NENI 9

NJOFTIMET

1. Të gjitha njoftimet, aplikacionet nga kandidatët, ofertat ose komunikimet e tjera që kërkohen ose lejohen për t'u dhënë në pajtim me këtë Kontratë duhet të bëhen me shkrim dhe mund të dorëzohen personalisht ose dërgohen përmes postës së Kosovës. Njoftimet llogariten se janë dorëzuar me sukses pas tetë (8) ditë pune pas dorëzimit në postë, përmes postës me rekomandë dhe letër-kthim.

NENI 10

DISPOZITA TË TJERA

1. Kjo kontratë është hartuar në gjuhën shqipe.
2. Njoftimet për shkelje ose shkëputje të kësaj kontrate ose dërgim të kontestit për gjykim duhet të bëhen personalisht ose përmes postës rekomande dhe nuk mund të dërgohen përmes postës elektronike.

3. Titujt e kësaj kontrate shërbejnë vetëm për t'iu referuar më lehtë asaj dhe nuk kanë ndonjë rëndësi në interpretimin e kësaj kontrate.
4. Kjo kontratë përfshinë gjithë marrëveshjen në mes të palëve. Të gjitha negociatat e mëparshme, marrëveshjet verbale dhe mirëkuptimet në lidhje me këtë çështje zëvendësohen me këtë kontratë.
5. Asnjë marrëveshje që ka për qëllim ndryshimin, modifikimin, shpjegimin apo plotësimin e afateve dhe kushteve të kësaj kontrate nuk është e detyrueshme për palët, përveç nëse dhe deri sa ajo të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga të dyja palët.
6. Asnjë palë e tretë nuk do të ketë apo të ushtrojë ndonjë të drejtë sipas kësaj kontrate pa pëlqimin paraprak me shkrim të palëve.
7. Nëse me vendim të plotfuqishëm të gjykatës vendoset se ndonjë dispozitë e kësaj kontrate është joligjore, e pavlefshme apo e pazbatueshme, dispozitat e tjera vazhdojnë të mbesin në fuqi dhe zbatohen.

NENI 11

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE LIGJI I APLIKUESHËM

1. Kjo kontratë i nënshtrohet ligjit të aplikueshëm në Kosovë në kohën e lidhjes së kësaj kontrate.
2. Palët pajtohen që në rast të kontestit ndërmjet tyre, mosmarrëveshjet fillimisht t'i zgjidhin përmes ndërmjetësimit jo-formal, në një seancë të vetme, e cila do të mbahet në Viti apo çfarëdo vendi tjetër të pëlqyer për palët, nën praninë e një ndërmjetësuesi të caktuar me pajtimin e palëve, apo vetëm me propozimin e njëres palë. Kjo seancë duhet të mbahet brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës për një seancë të tillë.
3. Nëse palët në kontest nuk ka marrë pjesë në ndërmjetësim, apo mosmarrëveshja nuk është zgjidhur me marrëveshje me shkrim pas seancës së ndërmjetësimit, palët janë të lira të paraqesin padi me të cilin rast kompetente do të jetë Gjykata Themelore në Gjilan, dega në Viti.

NENI 12

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Kjo kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga të dyja palët.

2. Kjo kontratë është hartuar në gjashtë (5) kopje identike, nga një (1) kopje për secilën palë, dhe secila prej të cilave konsiderohet origjinale.

PALËT KONTRAKTUESE

FOUNDATION KOSOVO - LUXEMBOURG

Z. Fisnik Beqiri, Drejtor Menaxhues



Z. Izjah Ademi, Zyrtar i Aktivitetit






KOMUNA E VITISË

Z. Sokol Haliti



KOMUNITETI SMIRË



Përfaqësuesi i komunitetit